



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

KOMISIONI I BUXHETIT, FINANCËS DHE TAKSAVE-TARIFAVE

Datë 08.07.2026

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin *(titulli i projektvendimit)*: **PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË VLERËS FINANCIARE PREJ 109,276,634 (NJËQIND E NËNTË MILION E DYQIND E SHTATËDHJETË E GJASHTË MIJË E GJASHTËQIND E TRIDHJETË E KATËR) LEKË, PËR LIKUIDIMIN E PLOTË TË FAMILJEVE TË PATRAJTUARA DHE PËR PËRFUNDIMIN E LIKUIDIMIT TË FAMILJEVE TË TRAJTUARA PJESËRISHT FINANCIARISHT, NË ZBATIM TË VKB-SË NR. 75, DATË 23.12.2025 TË DËMTUARA NGA PËRMBYTJET E SHKAKTUARA NGA RESHJET INTENSIVE TË SHIUT TË DATAVE 29.01.2025 – 30.01.2025**

Baza ligjore:

Në zbatim të Ligjit nr.139 dt.17/12/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligji nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies të ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Vendimit të Këshillit të Bashkiak nr. 73, datë 23.12.2026 2 “Për miratimin e buxhetit të bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesem 2026-2028”, shkresës së Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile për vitin 2026, për Bashkinë Durrës me kodin e produktit AB, sipas shkresës nr. 429/6 prot, datë 15.04.2026, për financimin e ndihmës financiare për familjet përfituese.

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër *(Çfarë propozohet në projektvendim)*:

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë konform akteve ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e fondit në vlerën 109,276,634 (njëqind e nëntë milion e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e katër) lekë, për përfundimin e likuidimit të plotë të detyrimit financiar ndaj familjeve përfituese të miratuara me VKB-në nr. 75, datë 23.12.2025, sipas Aneksit nr. 1 dhe Aneksit nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e Aneksit nr. 1, kolona 5, për 35 familje të patrajuara financiarisht, të cilat do të likuidohen plotësisht me këtë vendim. Vlera e fondit për likuidimin e këtyre familjeve është 2,413,104 (dy milionë e katërqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e katër) lekë.
3. Miratimin e Aneksit nr. 2, kolona 6, ku pasqyrohen 342 familje të miratuara me VKB-në nr. 75, datë 23.12.2025. Me këtë vendim propozohet miratimi i likuidimit të plotë të diferencës së mbetur të ndihmës financiare për 62 familje, të trajtuara pjesërisht, si dhe likuidimi i plotë i ndihmës financiare për 280 familje, të cilat nuk kanë përfituar asnjë pagesë në zbatim të VKB-së nr. 75, datë 23.12.2025. Vlera totale e fondit për likuidimin e plotë gjatë vitit 2026 është 106,863,530 (njëqind e gjashtë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë.
4. Likuidimet e kryera në zbatim të VKB-së nr. 75, datë 23.12.2025, njihen si pjesë e detyrimit financiar të përmbushur ndaj familjeve përfituese dhe mbeten në fuqi. Me këtë vendim miratohet likuidimi i diferencës së mbetur të ndihmës financiare për familjet që kanë përfituar pagesë të pjesshme, si dhe likuidimi i plotë i ndihmës financiare për familjet që nuk janë trajtuar financiarisht me asnjë kësht, sipas përcaktimeve të Aneksit nr. 1 dhe Aneksit nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Familjet që janë likuiduar plotësisht në zbatim të VKB-së nr. 75, datë 23.12.2025, konsiderohen me detyrimin financiar të shlyer plotësisht dhe, për rrjedhojë, nuk janë objekt i likuidimeve të mëtejshme sipas këtij vendimi.
6. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë, Mbrojtjes Civile.

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transfertat etj):

Fonde nga buxheti i shtetit dhe nga buxheti i bashkisë.

Drejtoria/Spektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Drejtoria e Zhvillimit Rural, Bujqësisë dhe Mbrojtjes Civile

Impakti social/grupet që preken:

Banorët e Bashkisë Durrës.

A është objekt konsultimi: (PO/JO)

JO.

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, u mbledhë më datë 08.07.2026, dhe shqyrtoi pikën nr. 17 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Pika 17 e rendit të ditës ka të bëjë me parimin nga të gjithë për votim në Këshillin Bashkiak
Francis

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
- e- _____

Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave

Kryetar

Rolant Xhelilaj


PRO 

Zv/Kryetar

Erzen Laçi

Sekretar

Hekuran Markola

PRO 

Anëtar

Jonada Mamo

PRO 

Anëtar

Alfred Mullaraj

PRO 

Anëtar

Kastriot Xhongoli

PRO 

Anëtar

Silvana Agasi

Anëtar

Dritan Burgija

Anëtar

Jonuz Myshketa

PRO 

Anëtar

Xhojana Gjineci

Anëtar

Kontjana Kuçi